**VENDIM**
**Nr.91, datë 30.11.2010**

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SUBJEKTIT "COLACEM ALBANIA SHPK"**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5 pika 2 të rregullores "Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.17, datë 6.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga subjekti "Colacem Albania sh.p.k." për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores "Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar" dhe vendimit nr.8, datë 29.1.2010 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010" si më poshtë:

- Neni 4 germa "a" është plotësuar konform rregullores.
- Neni 4 germa "b" është plotësuar konform rregullores.
- Neni 4 germa "c" është plotësuar konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të klientit të kualifikuar subjektit "Colacem Albania sh.p.k.".
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Bujar Nepravishta**